



Pranuar / Dorezuar Puniljena/Prodato Received/Delivery	12.11.2020	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/STCK	2564/2020		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 270/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.270/2020, të datës 15.09.2020, e parashtruar nga [redacted], me adresë banimi Rr. "Iliria", Bregu i Diellit 2, Prishtinë, kundër organit të punësimit Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 10.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.270/2020 e datës 15.09.2020, e parashtruar nga ankuesja [redacted].
- II. Vendimi hy në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] sipas Akt Emërimit të datës 02.04.2012 Nr.Protokolli 04-112.212 është e punësuar në vendin e punës "Zyrtare e Lartë" me koeficient aktual të pagës shtatë (7) në Sektorin e Shpërndarjes-Desiminimit-Departamenti i Teknologjisë Informative dhe Metodologjisë, pranë Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Me datë 24.07.2020, ankuesja ka parashtruar kërkesë me Nr.Protokolli 04-052-2495 të Drejtorit i Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil (me tej DASHC) në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më të cilën ka kërkuar harmonizimin e koeficientit të pagës nga koeficienti shtatë(7) në koeficientin tetë (8) pasi që pozita e saj është emërtuar dhe konfirmuar nga DASHC " Zyrtare e Lartë për Statistika" me Kod ST/500, koeficient 8, e cila pozitë është e përfshirë edhe në Katalogun e Vendeve të Punës.

Më datë 28.08.2020, Udhëheqësi i Divizionit për Politika të Pagave në Departamentin për Administrimin e Shërbimit Civil (DASHC, përmes e-mailit ka njoftuar ankuesen se duke u aplikuar kriteret për klasifikimi e vendeve të punës, në përshkrimin e detyrave, përgjegjësi si dhe kompleksitetin e punës, pozita e juaj është e barasvlershme me koeficientin tetë (8), si



dhe informon ankuesen se DASH është përgjegjës për politika te pagave gjegjësisht për vlerësim, aprovimin dhe klasifikimin e pozitave të punës në koeficientin përkatës të pagës apo gradë, ndërsa institucioni punëdhënës është përgjegjës për sistemin e nëpunësve në vendet përkatëse të punës.

Ankuesja, duke marr parasysh se njoftimi i DASHC-se nuk është zbatuar nga Menaxherja e Personelit të ASK-së, me datë 15.09.2020 ka parashkruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. Protokolli 1769/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 21.09.2020 ka proceduar tek Agjencia e Statistikave të Kosovës kërkesën për përgjigje në ankesë, ndërsa kjo e fundit me datë 02.10.2020 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku e provat e lëndës.

Bazuar në Nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin Nr.012/2020 të datës 29.10.2020 Këshilli ka vazhduar afatin e ankesës edhe për 10 ditë pune për shkak të specifikës së lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosje meritore lidhur me çështjen ka administruar këto prova: Ankesën A. nr.270/2020 e parashtruar më datë 15.09.2020, me numër protokolli 1769/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 21.09.2020; Akt Emërimi i datës 28.03.2012;Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 06.01.2016; e-mail i datës 29.01.2016; e-mail i datës 02.02.2016; e-mail i datës 02.02.2016; e-mail i datës 16.02.2016; e-mail i datës 29.01.2016; e-mail i datës 01.03.2016; e-mail i datës 29.01.2016; e-mail i datës 01.03.2016; Kërkesë për harmonizim të koeficientit i datës 24.07.2020; e-mail i datës 27.08.2020; e-mail i datës 24.07.2020; e-mail i datës 28.08.2020; e-mail i datës 03.09.2020; e-mail i datës 03.09.2020; e-mail i datës 28.08.2020; e-mail i datës 03.09.2020; e-mail i datës 03.09.2020; e-mail i datës 07.09.2020; e-mail i datës 03.09.2020; e-mail i datës 03.09.2020; e-mail i datës 28.08.2020; e-mail i datës 09.09.2020; e-mail i datës 07.09.2020; e-mail i datës 03.09.2020; e-mail i datës 03.09.2020; e-mail i datës 28.08.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.12.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.12.2019; Organogrami i ASK-së; Përgjigje në ankesë e datës 02.10.2020; e-mail i datës 28.08.2020; e-mail i datës 29.01.2016; e-mail i datës 02.02.2016; e-mail i datës 02.02.2016; e-mail i datës 16.02.2016; e-mail i datës 29.01.2016; e-mail i datës 01.03.2016; e-mail i datës 29.01.2016; e-mail i datës 01.03.2016; e-mail i datës 29.02.2016; e-mail i datës 28.08.2020; e-mail i datës 29.01.2016; e-mail i datës 02.02.2016; e-mail i datës 02.02.2016; e-mail i datës 16.02.2016; e-mail i datës 29.01.2016; e-mail i datës 01.03.2016; e-mail i datës 29.01.2016; e-mail i datës 01.03.2016; e-mail i datës 29.02.2016; Vendim i datës 29.10.2020; Kërkesë për shtyrje të afatit për vendosjen e ankesës i datës 29.10.2020; shkresa e Komisionit për klasifikim të vendeve të punës 15.07.2016 si dhe lista e klasifikimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuses *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuses [REDACTED], e cila kërkon njohjen e harmonizimit të koeficientit, nga koeficienti shtatë (7) në koeficientin tetë (8), sipas njoftimit të datës 28.08.2020, të lëshuar nga



Udhëheqësi i Divizionit për Politika të Pagave/Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil.

Kolegji për shqyrtim dhe vendosje të ankesave ka konstatuar se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 02.04.2012 Nr. Protokolli 01-112-212, është emëruar në Pozitën " Zyrtares e Lartë" në Sektorin e Shpërndarjes dhe Desiminimit, me koeficient të pagës shtatë (7) dhe si të tillë e ka nënshkruar Akt Emërimin. Ndërsa sipas Ndryshim dhe Plotësim të Aktit të Emërimit dhe përshkrimit të detyrave të punës të datës 06.01.2016, ankuesja ka emërtimin e vendit të punës "Zyrtare e Sektorit të Shpërndarjes-Desiminimit, me koeficient shtatë (7).

Sipas shkresës (E-mailit) të DASHC të datës 01.03.2016, pozita e ankueses "Zyrtare e lartë e desiminimit" është aprovuar me emërtimin " Zyrtares e lartë për statistika" ndërsa nga verifikimi i Katalogut të Vendeve të punës i miratuar nga Qeveria me vendimin nr.02/2015 të datës 05.02.2015, i ndryshuar me datë 21.02.2018 , pozita "Zyrtar i Lartë për Statistika" ka kod të punës ST/500 me gradë 8 (tetë).

Po nga shkresat e lëndës, kolegji gjen se punëdhënësi-Agjencia e Statistikave të Kosovës sipas kërkesës së DASHC-së, ka themeluar Komisionin për klasifikimin e vendeve të punës, ku me datë 15.07.2016 ky Komision ka përcjell në DASHC raportin e klasifikimit të vendeve të punës në Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Ky raport me asnjë shkresë nuk vërtetohet se është aprovuar nga organet gjegjëse respektivisht nga Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike ashtu siç parashihet me ligj.

Sipas Raportit të Komisionit, ankuesja është propozuar që te ketë emërtimin e punës "Udhëheqëses se Divizionit për Kualitet të Kontrollit "me kod BF/1020 gradë shtatë (7).

Nga analizimi i provave, Kolegji konstaton se njoftimi i datës 28.08.2020, i lëshuar nga Udhëheqësi i Divizionit për Politika të Pagave/DASHC, nuk konsiderohet aprovim i kërkesës së ankueses për ngritje të koeficientit nga shtatë (7) në tetë (8) por si vlerësim i klasifikimit të vendeve të punës bazuar në përshkrimin e detyrave të punës dhe se me asnjë akt te Udhëheqësit më të lartë të organit të punësimit nuk është miratuar paraprakisht një kërkesë për ngritje të koeficientit të ankueses.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji vlerëson se çdo procedurë për harmonizim dhe klasifikim te vendeve të punës dhe koeficienteve të pagës, duhet të zhvillohet në respektim të procedurave që kërkohen sipas Rregullores Nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr.03/2010 për përshkrimin e vendeve të punës.

Andaj, Kolegji për shqyrtim dhe vende të ankesave ka konstatuar se ankesa e ankueses është në kundërshtim më me nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i cili përcakton " Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitave në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat".

Bazuar në gjendjen faktike dhe juridike të lartë cekur, Kolegji për shqyrtim dhe vendosje bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A. Nr.270/2020**

Çlirim Zeka



Procesmbajtësi

Ardita Haxhnikaj Demi



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses ██████████;
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Statistikave të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

